

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 09.04.2021

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike **NIEM SHPK me NIPT K36609610Q** Adresa: Korce Qender Bilisht Bitincke Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Bitincke & **ARTYKA II SHPK me Nipt K26625603U**, Adresa: Korce Bilisht Rruga e Mirasit, Km.i I, Prane Ish Nyjes se Inerteve, Bilisht

Procedura e prokurimit: **Procedure e Hapur -Pune**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-87426-02-17-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ” *Rehabilitimi i rrugeve te qyetetit te Bilishtit 2*”

**Fondi limit: 68 145 119.3** (gjashtedhete e tete milion e njeqind e dyzet e pese mije e njeqind e nentembedhete pike tre) leke pa TVSH

Buletini i Njoftimeve Publike [22.02.2021] [26]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. AVDOLLI SHPK**

**NIPT K14721001P**

Vlera: 53 834 487.6 ( pesedhete e tre milion e teteqind e tridhjte e kater mij e katerqind e tetedhete e shtate pike gjashte) lekë pa tvsh

**2. B.O.E. NIEM SHPK K36609610Q & ARTYKA II SHPK NIPT K26625603U**

Vlera: 67 794 015( gjashtedhete e shtate milion e shtateqind e nentedhete e kater mije e pesembedhete) leke pa tvsh

**Jane skualifikuar Ofertuesit e meposhtem:**

**AVDOLLI SHPK**

**NIPT K14721001P**

**Perkatesisht per arsyet e meposhtme:**

Operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ploteson:

-Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri dt 09.12.2020

-Piken 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :\*OE me punën e ngjashme paraqitur me object 1- “Sistemim asfaltim I rruges hyrese ne fshatin Zvirine” realizuar si BOE 53.3 % te vleres totale prej 13,270,194 Leke me tvsh, 2- “Rrethim varreza” realizuar si BOE 72.7 % te vleres totale prej 4,214,199 Leke me tvsh, nuk pëmbushin kërkesat e kesaj pike per kualifikim.

-Piken 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021,;

\*OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në këtë pikë për kualifikim

-Piken 2.3.3 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet

\*OE nuk ka paraqitur kandidatë për të përmbushur kërkesat e kësaj pike për kualifikim

-Piken 2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik punonjës nga të cilët të jenë:

2 (dy) teknik ndertimi

4 (kater) pllaka shtrues

5 (pese) karpentier

1 (nje) hidraulike

2 (dy) elektriciste

8 (tete) shofere

13 (trembedhjete) manovratore

\*OE nuk ka paraqitur kandidatë për të përmbushur kërkesat e kësaj pike për kualifikim

-Piken 2.3.5 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”,

\*Ose/sipas VKM Nr.108, date 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë“, i ndryshuar, ku parashikohet se, nëse punëdhënësit nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë, mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

\*OE nuk ka paraqitur kandidatë për të përmbushur kërkesat e kësaj pike për kualifikim

-Pikwn 2.3.6 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

## PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

N.P – 4. C Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

N.P – 12. A Punime te inxhinierise se mjedisit.

\*OE nuk ka kategorite e nevojshme ne License per te permbushur kerkesat e kesaj pike per kualifikim

-Piken 2.3.7 Operatori/et ekonomike ofertues duhet te disponoje dhe paraqese Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

\*OE ofertues nuk ka paraqitur Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike te kerkuara ne kete pike, qe te disponoje Numrin dhe llojin e tyre, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

-Piken 2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a)PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.

b)PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

\*Operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion e kerkuar ne kete pike per kualifikim:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike **NIEM SHPK me NIPT K36609610Q** Adresa: Korce Qender Bilisht Bitincke Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Bitincke & **ARTYKA II SHPK me Nipt K26625603U**, Adresa: Korce Bilisht Rruga e Mirasit, Km.i I, Prane Ish Nyjes se Inerteve, Bilisht

se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 67 794 015( gjashtedhjetë e shtate milion e shtateqind e nentedhjetë e kater mije e pesembedhjetë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Devoll me adrese Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit

vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.03.2021**

Ankesa: ka ose jo: JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**EDUARD DURO**